

# **AKT THEMELIMI**

## **I SHOQËRISË “NEW ELECTRIC DIVELOPMENT” SH.P.K**

**Eduard Çomollari**, lindur më 22.02.1964 në Tiranë dhe banues në Tiranë, me letërnjoftim nr. 034932185, dhe nr. personal **G40222058S**, shtetas shqiptar.

**Genci Plaka**, lindur më 05.06.1962 në Tiranë dhe banues në Tiranë, me letërnjoftim nr.039142394, dhe nr. personal **G20605164Q**, shtetas shqiptar.

Shprehim dëshirën sipas kërkesave të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, dhe Ligjit Nr. 9723, date 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar, për krijimin e shoqërisë me të dhënat e mëposhtme :

### **NENI 1**

Themeluesi me anën e këtij akti themelimi krijon një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të cilën do ta emërtojë “**NEW ELECTRIC DIVELOPMENT**”, shoqëri e cila do të veprojë në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe në përputhje me dispozitat e Statutit që i bashkëlidhet këtij Akt Themelimi.

### **NENI 2**

Selia kryesore e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresën: **Rruga “Komuna e Parisit”, Pallatet 1 Maji, H.13, Ap.20, Njesia Administrative Nr.5.**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë për një periudhë **kohe të pakufizuar, mbi 10 vjet**, me të drejtë përsëritje për periudhën e mëtejshme, nëqoftëse Asambleja e Ortakëve bie dakord, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### NENI 3

Shoqëria do të ushtroje aktivitetin në fushën e:

**Shërbime elektrike, elektronike, të rrjeteve telefonike dhe të sinjalizimeve të sistemeve të alarmit. Projektme dhe zbatime të sistemeve të ndryshme. Specialist në fushën elektrike dhe elektronike. Shërbime hidroteknike. Shërbim montimi dhe instalimi të impianteve të ndryshëm. Tregtim të artikujve të ndryshëm. Punime të ndryshme. Shërbime instalimi të lëndëve zjarrfikëse dhe impianteve te tyre si dhe të impianteve të kondicionimit.**

### NENI 4

Kapitali themeltar i shoqërisë është **100.000,00** (Njëqind mijë) lekë. Ky kapital ndahet si më poshtë:

Ortaku **Eduard Çomollari**, zotërues i 1 (një) kuote, përqindja e pjesëmarrjes **50.00**; me vlerë **50.000,00** lekë.

Ortaku **Genci Plaka**, zotërues i 1 (një) kuote, përqindja e pjesëmarrjes **50.00**; me vlerë **50.000,00** lekë.

### NENI 5

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimeve që do të marrë ortaku. Në rast se kapitali i shoqërisë për shkak të humbjeve të vërtetuara në dokumentet financiare rezulton me i vogël se gjysma e kapitalit themeltar, ortaku vendos brenda tre muajve nga miratimi i llogarive të përcaktojë këtë humbje mbi mundësinë e prishjes së parakohshme të shoqërisë. Në rast se prishja nuk shpallet, shoqëria zvogëlon kapitalin e saj me një vlerë jo më të vogël se ajo e humbjeve që kanë mbetur, pa mbuluar fondet rezervë.

## NENI 6

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuota të kapitalit të tyre, tërësisht apo pjesërisht të shoqërisë, të cilët kanë të drejtën e parablerjes qoftë edhe në kushte të barabarta. Kjo e drejtë duhet ushtruar brenda 30 ditëve nga data e komunikimit.

## NENI 7

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e Ortakëve;
- Administratori.

**Afati i emërimit të administratorit është deri në 5 vjet, me të drejtë ripërsëritje, në bazë të nenit 95 të Ligjit 9901, dt. 14.04.2009, siç është përcaktuar në Statut.**

Procedura për emërimin në funksionet përkatëse dhe shkarkimin e tij rregullohen sipas Statutit të shoqërisë.

## NENI 8

Në mbledhjen e parë të Asamblesë emërohet administrator i shoqërisë **Z. Eduard Çomollari**, lindur më 22.02.1964, në Tiranë dhe banues në Tiranë, me letërnjoftim nr.034932185, dhe nr. personal **G40222058S**

## NENI 9

Vendimet e Asamblesë së Ortakëve mund të merren edhe nëpërmjet konsultimit me shkrim.

## NENI 10

Likuiditetet dhe transaksionet financiare do të depozitohen në bankat shqiptare dhe në ato të huaja, ku shoqëria ka llogaritë e saj rrjedhëse. Për kapitalin themeltar të shoqërisë është hapur libri i llogarive ku do të shënohet kontributi i ortakëve. Po kështu, shoqëria ka dhe përdor dokumentacionin sipas kërkesave të ligjit për kontabilitetin dhe gjithë kërkesave të tjera financiare të domosdoshme për veprimtarinë normale të saj.

#### NENI 11

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria i mbeten ortakëve në përpjesëtim me kontributin në kapitalin themeltar të shoqërisë, mbasi të jenë likuiduar të gjitha detyrimet, dhe të jetë hequr 5 përqindëshi që do të futet në fondin e rezervës ligjore deri në përmbushjen e 1/10 së kapitalit të shoqërisë.

#### NENI 12

Shoqëria fillon veprimtarinë e saj vetëm pasi të ketë marrë autorizimin e organeve kompetente sipas legjislacionit në fuqi.

#### NENI 13

Ortakët, administratori dhe çdo i punësuar në shoqëri, janë të detyruar që të ruajnë karakterin sekret të dokumentacionit, të eksperiencës së shkëmbyer, të realizuar brenda veprimtarisë së shoqërisë .

#### NENI 14

Të gjitha mosmarrëveshjet që nuk mund të zgjidhen me mirëkuptin, do të paraqiten për zgjidhje në gjykatën kompetente shqiptare, në përputhje me legjislacionin në fuqi .

#### NENI 15

Ky Akt Themelimi u përpilua në prani të Asamblesë së Ortakëve duke shprehur në të, vullnetin e lirë të tyre.

Akti i Themelimit u përpilua në tri kopje me fuqi të barabarta secila, për t'u depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit, si dhe dy kopje të ruhen në dokumentacionin bazë të shoqërisë.

Tiranë, më 14.08.2024

### ASAMBLEJA E ORTAKËVE TË SHOQËRISË “NEW ELECTRIC DEVELOPMENT”

(Eduard ÇOMOLLARI)

( Genci PLAKA)